



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Trupi Gjykes II

Gjykatës Çarls L. Smith III, kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 14 mars 2023

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Ndryshimin e Numrit të  
Lejuar të Fjalëve**

---

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të  
Specializuar**  
Aleks Uajting

**Mbrojtësit të Viktimave**  
Sajmon Loz

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit**  
Gregori Kihou

**Mbrojtjes së Kadri Veselit**  
Ben Emerson

**Mbrojtjes së Rexhep Selimit**  
Dejvid Jang

**Mbrojtjes së Jakup Krasniqit**  
Venkatesvari Alagenda

**TRUPI GJYKUES II** ("Paneli), në bazë të nenit 40(2) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe neneve 36(1) dhe 41 të Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara ("Udhëzuesi i Punës"),<sup>1</sup> nxjerr vendimin e mëposhtëm.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 8 mars 2023, Mbrojtja e Hashim Thaçit, Mbrojtja e Kadri Veselit, Mbrojtja e Rexhep Selimit dhe Mbrojtja Jakup Krasniqit (bashkërisht "Mbrojtja") parashtrori kërkesën e përbashkët për ndryshimin e numrit të lejuar të fjalëve ("Kërkesa për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve").<sup>2</sup>

2. Më 10 mars 2023, Trupi Gjykses njoftoi palët dhe pjesëmarrësit se: (i) nëse dëshironin t'i përgjigjeshin Kërkesës, ata duhej ta bënin këtë deri të hënën, më 13 mars 2023, në mesditë; dhe (ii) Trupi Gjykses nuk do të pranojë kundërpërgjigje.<sup>3</sup> As palët, as pjesëmarrësit nuk u përgjigjën.

## II. PARASHTRIME

3. Mbrojtja parashtron se synon të dorëzojë një përgjigje të përbashkët ("Përgjigja") ndaj kërkesës së Prokurorit të Specializuar për pranimin e provave jogojore ("Mocioni i Provave Jogojore").<sup>4</sup> Mbrojtja kërkon një shtesë prej jo më shumë se 15.000 fjalësh për Përgjigjen e vet, meqenëse Mocioni i Provave Jogojore kërkon pranimin e 1.260 dokumenteve të cilat bëhen afërsisht 13,500 faqe gjithsej.<sup>5</sup> Ajo argumenton se Kërkesa për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve mbështetet

---

<sup>1</sup> KSC-BD-15, *Udhëzuesi i Punës të Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës*, 17 maj 2019.

<sup>2</sup> F01354, *Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve*, 8 mars 2023.

<sup>3</sup> CRSPD185, *Përgjigje ndaj F01354 dhe F01358*, 10 mars 2023.

<sup>4</sup> Kërkesa për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 1.

<sup>5</sup> Kërkesa për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, paragrafët 1, 3.

në arsye të vlefshme dhe asnjë dëm nuk i shkaktohet ZPS-së apo Mbrojtësit të Viktimave.<sup>6</sup>

### III. DISKUTIM

4. Për sa i përket kohës së dorëzimit të Kërkesës për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, Trupi Gjykes gjykon se ajo është dorëzuar në kohën e duhur duke pasur parasysh faktin se afati për Përgjigjen është më 21 mars 2023.<sup>7</sup>

5. Për sa i përket kushtit për arsye të vlefshme, Trupi Gjykes merr parasysh: (i) gjatësinë, vëllimin dhe shumëllojshmërinë e dokumenteve të provave jогоjore; dhe (ii) faktin se një përgjigje përmbledhëse do të shmangte përsëritjet e panevojshme, duke shtuar, në këtë mënyrë, efikasitetin. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes është bindur që ka arsye të vlefshme për të justifikuar shtimin e numrit të lejuar të fjalëve deri në jo më shumë se 15.000 fjalë, aq sa kërkohet nga Mbrojtja.

6. Duke marrë parasysh faktin se shtimi i numrit të lejuar të fjalëve do t'i hapë rrugë një përgjigjeje përmbledhëse, Trupi Gjykes vëren se miratimi i Kërkesës për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve nuk do t'i shkaktojë dëm as ZPS-së dhe as Mbrojtësi të Viktimave.

---

<sup>6</sup> Kërkesa për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 5.

<sup>7</sup> F01309, Trupi Gjykes II, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Mocion të Rishikuar për Provat Jогоjore dhe Pezullim e Zgjatje Afati*, 21 shkurt 2023, para. 16(c).

IV. VENDIM

7. Për këto arsye, Trupi Gjykses:

- (a) **MIRATON** Kërkesën për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve; dhe
- (b) **SHTON** numrin e lejuar të fjalëve për Përgjigjen deri në jo më shumë se 15.000 fjalë.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatës Çarls L. Smith III**  
**Kryegjykatës**

E martë, 14 mars 2023

Hagë,

Holandë.